



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
BERAT**

**RAPORTI VJETOR I DREJTUESIT TË
PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË
SHKALLËS SË PARË BERAT MBI ECURINË
E PUNËS NË PROKURORI
PER VITIN 2019**



Berat, shkurt 2020

PËRMBAJTJA

Fjala hyrëse	<i>Page</i>5
I. Drejtimet dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit në vitin 2019.....	6
➤ <i>Respektimi i të drejtave të njeriut.....</i>	6
➤ <i>Të miturit dhe grupet vulnerabël, të pandehur dhe viktima.....</i>	6
➤ <i>Bashkëpunimi ndërinstytucional</i>	7
➤ <i>Bashkëpunimi ndërkombëtar.....</i>	8
➤ <i>Përdorimi i metodave speciale të hetimit dhe hetimet proaktive.....</i>	8
➤ <i>Informacion mbi zbatimin e Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm.....</i>	8
➤ <i>Informacion mbi zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 20.06.2019 “Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë.....</i>	9
➤ <i>Informacion mbi zbatimin e rekomandimeve prioritare “Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2019”, miratuar me vendimin nr. 296, datë 10.05.2019 të Këshillit të Ministrave.....</i>	10
➤ <i>Informacion statistikor mbi çështjet penale që lidhen me procesin e verifikimit të Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emërohen ose Ushtrajnë Funksione Publike.....</i>	15
➤ <i>Të dhëna lidhur me trajnimet e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.....</i>	15
➤ <i>Problematikat e konstatuara.....</i>	15
II. Analiza e treguesve të kriminalitetit dhe punës së prokurorisë.....	17
➤ <i>Volumi i punës në hetim.....</i>	17
➤ <i>Çështje të përfaqësuara në gjykatë.....</i>	18

➤	<i>Treguesit kryesorë të punës së prokurorisë.....</i>	18
➤	<i>Të dhëna në lidhje me njoftimet për veprat penale</i>	19
➤	<i>Të dhëna në lidhje me masat e sigurimit personal e pasuror.....</i>	20
➤	<i>Treguesit e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.....</i>	20
➤	<i>Kriminaliteti sipas shtrirjes territoriale.....</i>	20
➤	<i>Kriminaliteti sipas përhapjes së veprave penale dhe tendencave të tyre</i>	21
➤	<i>Kriminaliteti sipas strukturës së Kodit Penal (krime-kundërvajtje).....</i>	21
III.	Treguesit statistikorë 2 vjeçarë të veprave penale sipas strukturës së Kodit Penal.....	21
➤	<i>Në vitin 2017.....</i>	21
➤	<i>Në vitin 2018.....</i>	21
IV.	Analiza e treguesve të efektivitetit të punës së prokurorisë.....	22
➤	<i>Treguesi i efektivitetit në gjykimin dhe dënimin e të pandehurve.....</i>	22
➤	<i>Të dhëna për gjykimet e posaçme.....</i>	22
➤	<i>Të dhëna mbi llojet dhe masat e dënimeve</i>	22
➤	<i>Të dhëna sociale dhe demografike për të pandehuri.....</i>	23
➤	<i>Të dhëna për të pandehurit e mitur</i>	23
➤	<i>Të dhëna për pasojat e veprave penale</i>	23
V.	Të dhëna lidhur me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja.....	24
➤	<i>Ekstradime, Letërporosi, Transferime procedimesh, Transferime te dënuarish, Shpalljet/Heqjet nga kërkimi ndërkombëtar.....</i>	24
VI.	Të dhëna për ngarkesën e punës për çdo prokuror dhe oficer të policisë gjyqësore.....	25
➤	<i>Eloida Goxhi.....</i>	25
➤	<i>Tasim Puci.....</i>	25

➤ Olgert Rumnici.....	25
➤ Dritan Gripshi.....	25
➤ Gentian Habazaj.....	25
➤ Albjona Papajani.....	25
➤ Romir Cufe.....	25
➤ Erind Cela.....	26
➤ Gertmond Koroveshi.....	27
VII. Informacion mbi administrimin e Prokurorisë.....	27
VIII. Drejtimet dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2019. Rekomandime.....	29
- <i>Tabelat e treguesve statistikorë bashkëlidhur raportit (vitet 2017, 2018)</i>	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
BERAT**

**RAPORTI VJETOR I DREJTUESIT TË
PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË BERAT MBI
ECURINË E PUNËS NË PROKURORI
PER VITIN 2019**

DREJTUAR

**PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM
Z. Olsian ÇELA**

TIRANË

I nderuar Z. Prokuror i Përgjithshëm!

Në këtë raport synojmë të prezantojmë të dhënat dhe treguesit e ecurisë së veprimtarisë së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat për vitin 2019.

Ky raport përmban të dhëna që i referohen veprimtarisë së Prokurorisë në fazën e hetimit paraprak, në fazën e gjykimit, në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale, të bashkëpunimit ndërkombëtar si edhe zbatimit të detyrimeve të tjera ligjore të normuara në ligjin procedural penal, në ligje të tjera apo akte nënligjore.

Metodologjia e këtij raporti, në përputhje edhe me raportet e viteve paraardhëse, konsiston në mbledhjen e të dhënave statistikore të punës së prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, në sintezën e këtij informacioni dhe analizën e aspekteve të veçanta në veprimtarinë dhe administrimin e Prokurorisë. Raporti është i organizuar i tillë që të jetë në përputhje me standardet e përcaktuara në urdhrin nr. 330, datë 29.12.2016 të Prokurorit të Përgjithshëm "*Për përmbajtjen e raportit vjetor të Drejtuesit të Prokurorisë*".

I. Drejtimit dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit në vitin 2019

➤ Respektimi i të drejtave të njeriut

Në kuadër të garantimit dhe respektimit të të drejtave të njeriut, vlerësoj se prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të seksionit të Prokurorisë kanë mbajtur vazhdimisht në konsideratë gjatë punës së tyre respektimin e të drejtave të njeriut.

Përpos përparësive në luftën ndaj kriminalitetit, siç janë hetimi i disa veprave penale, për të cilat ka një shqetësim në shkallë të gjerë në mbarë opinionin publik, por edhe në atë social, kulturor, juridik, ekonomik etj, si *shpërdorimi i detyrës, korrupsioni, falsifikimi* etj, nga prokurorët është mbajtur në konsideratë respektimi i të drejtave themelore dhe parimeve kushtetuese si e drejta për informim, parimi i prezumimit të pafajësisë, parimi i barazisë para ligjit, mosdiskriminimi, e drejta për të respektuar jetën private dhe familjare, e drejta e konfidencialitetit të të dhënave personale që mund të përftohen gjatë procesit hetimor, mosmarrja e të dhënave me anë të dhunës, trajtimi i diferencuar i grave dhe të miturve, e drejta për t'u njohur me akuzën, me shkaqet e arrestimit apo ndalimit dhe konfirmimi në gjykatë i ligjshmërisë së kryerjes së këtyre veprimeve etj. Nga ana e drejtuesit të Prokurorisë dhe prokurorëve janë bërë përpjekje që të njëjtat parime të udhëheqin punën edhe të oficerëve të policisë gjyqësore të drejtorisë vendore të policisë dhe komisariateve.

➤ Të miturit dhe grupet vulnerabël, të pandehur dhe viktima

Përgjatë vitit 2019, vlerësoj se Prokurorët kanë mbajtur në konsideratë të drejtat e këtyre grupeve të veçanta shoqërore, si të miturit dhe gratë, si në rastin kur mund të kenë pasur cilësinë e të pandehurit/personit nën hetim, ashtu edhe nëse kanë qenë viktima të ndonjë vepre penale.. Edhe për këtë vit, nga statistikat rezulton se të pandehurit e mitur janë kryesisht të përfshirë në veprat penale të “Vjedhjes” të llojeve të ndryshme. Në çështjet penale, ku autori i mitur është zbuluar pasi ka ndodhur vepra penale, prokurorët kanë orientuar oficerët e policisë gjyqësore, që të procedohet në përputhje me **“Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur”**, duke u treguar të kujdesshëm me masat kufizuese të lirisë, që ato të jenë në përputhje me direktivat që përmban ky kod, që në veprime procedurale me të miturin, të garantohet asistencë detyrimsht e mbrojtësit, psikologut, familjarit, si edhe në marrjen e masave për njoftimin e organeve vendore që kanë si kompetencë të tyre trajtimin social të të miturve. Sa i përket të miturve viktima apo deklarues, sërish nga ana e prokurorëve është orientuar që veprimet procedurale me këta shtetas të kryhen në praninë e psikologut dhe nëse ka qenë rasti, edhe të prindërve. Me të njëjtën rëndësi dhe vëmendje janë trajtuar rastet e grave, veçanërisht ato që janë viktima të një vepre penale. Megjithatë, në rastet e femrave dhe grave, aktualisht paraqitet problematike mungesa e oficerëve femra të policisë gjyqësore, të cilat janë të domosdoshme në rastet kur kodi i procedurës penale përcakton se viktima e dhunës seksuale ose ato të trafikimit mund/duhet të pyetet nga një oficer i së njëjtës gjini.

Përpos këtyre kategorive, nga ana e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore një vëmendje e veçantë u është kushtuar të moshuarve, personave me dëmtime fizike (të pandehur

ose viktima), si edhe viktimave të dhunës në familje ose dhunës seksuale. Kjo vëmëndje ka konsistuar në kryerjen e veprimeve hetimore të shpejta, të gjithanshme dhe dinamike, si edhe mbajtjen në konsideratë të një politike të drejtë dënimesh në rastet e këtyre të pandehurve.

➤ *Bashkëpunimi ndërinstytucional*

Gjatë vitit 2019 janë mbajtur raporte korrekte me institucione të tjera, në zbatim të ligjit procedural, ligjeve që rregullojnë veprimtarinë e organeve përkatëse dhe atij organik për Prokurorinë Shqiptare. Në këto marrëdhënie rolin kryesor e zënë ato që lidhen me:

- ❖ Prokurorinë e Përgjithshme dhe me Këshillin e Lartë të Prokurorisë
- ❖ Strukturat e policisë së shtetit dhe institucionet e tjera që kanë shërbime të policisë gjyqësore, për bashkëpunimin që lidhet me fazën e hetimit paraprak të procedimeve,
- ❖ Me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, për fazën që lidhet me përfaqësimin e akuzës në gjykim, me paraqitjet në seancat paraprake si në rastet e kërkesave për pushim, ashtu edhe në ato për gjykim
- ❖ Me Prokurorinë dhe Gjykatën e Apelit Vlorë, për fazën që lidhet me përfaqësimin e akuzës në çështjet e ankimuar, me njoftimin e vendimeve apo akteve të cilat kanë ekzekutim të menjëhershëm.
- ❖ Me institucione të tjera në nivel qendror dhe lokal.

Gjatë gjithë vitit 2019, ka patur një marrëdhënie shumë të ngushtë bashkëpunimi me të gjitha drejtoritë dhe sektoret e Prokurorisë së Përgjithshme dhe me Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Gjatë vitit 2019, përveç respektimit me rigozitet të detyrimeve ligjore dhe në funksion të rritjes së cilësisë së hetimit paraprak, është synuar edhe krijimi i një raporti të ngushtë bashkëpunimi me të gjitha strukturat e policisë së shtetit që veprojnë në qarkun e Beratit, si Drejtoria e Policisë së Qarkut dhe Komisaritet e Policisë në rrethet Berat, Skrapar dhe Kucove, si dhe strukturat e policisë rrugore. Rritjes së bashkëpunimit i ka shërbyer edhe institucionalizimi i takimeve të përbashkëta periodike ndërmjet drejtuesit të kësaj Prokurorie dhe drejtuesve të efektivave policore që disponojnë shërbimet e policisë gjyqësore. Megjithatë, në tërësi vlerësoj se ende ka nevojë që bashkëpunimi me strukturat e policisë të përmirësohet dhe institucionalizohet, pasi ky bashkëpunim kondicionohet edhe nga lëvizjet e shpeshta strukturore dhe transferimet e strukturave vendore të Policisë, kualifikimet e tyre në fushën e legjislacionit procedural penal, faktit që janë në varësi të Ministrisë së Punëve të Brendshme etj.

Lidhur me raportet e Prokurorisë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, vlerësoj se kanë qenë korrekte dhe ligjore, si në kërkesat që lidhen me fazën e hetimit paraprak, ashtu dhe atë të seancave paraprake, të gjyqimit të procedimeve dhe përfaqësimit të akuzës në gjyq. Prokurorëve u është kërkuar respektimi me korrektesë i pjesëmarrjes së tyre në gjykim, çka realisht është përmbushur në mënyrë konkrete.

Gjatë vitit 2019 ka vijuar komunikimi dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me Prokurorinë e Apelit Vlorë, në funksion të përfaqësimit sa më cilësor të akuzës në çështjet e ankimuar dhe me

njoftimin e vendimeve apo akteve të cilat kanë ekzekutim të menjëhershëm, apo ato akte të cilat kanë karakter ngutshëm.

Nga ana e Prokurorisë Berat është treguar gatishmëri e plotë për të bashkëpunuar edhe me institucione të tjera si Prefekti i Qarkut Berat, Bashkita e qarkut te Berat (Berat, Ura-Vajgurore, Skrapar, Kuçove dhe Poliçan), ne aktivitete që i shërbejnë parandalimit të përhapjes se veprave penale, sikurse janë ato në fushën e ndërtimeve pa leje, kultivimit të lëndëve narkotike, dhunës në familje, etj. Përgjithësisht, raportet me institucionet e tjera qendrore e vendore kanë qenë korrekte dhe institucionale.

Lidhur me bashkëpunimin me institucione të tjera të pavarura si ILDKPKI, KLSH, Avokati i Popullit etj, konstatojmë se është paraqitur gjatë vitit 2019 vetëm një kallëzim penal nga KLSH-ja ndaj Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Rajonale Berat për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, kallëzim për të cilin është regjistruar procedimi përkatës penal dhe çështja është në hetim.

➤ *Bashkëpunimi ndërkombëtar*

Me qëllim bashkëpunimin e efektshëm në ushtrimin e ndjekjes penale apo marrjen e masave dhe kryerjen e veprimeve të ndryshme procedurale, lidhur me veprat penale që kanë kryer shtetasit shqiptarë jashtë shtetit, apo shtetasit e huaj në qarkun e Beratit, nga ana e Prokurorisë Berat janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me Prokurorinë e Përgjithshme dhe Ministrinë e Drejtësisë, si dy organet kompetente që mundësojnë ndërmjetësimin e bashkëpunimit me autoritetet e huaja.

➤ *Përdorimi i metodave speciale të hetimit dhe hetimet proaktive*

Nga ana e prokurorëve të Prokurorisë Berat, në varësi të natyrës së veprës penale, janë zhvilluar hetime proaktive, disa prej të cilave kanë rezultuar të suksesshme. Kryesisht, janë zhvilluar hetime proaktive për hetimin e veprave penale në fushën e korrupsionit, narkotikëve, kalimit të paligjshëm të kufirit etj, duke përdorur kryesisht metodat hetimore të përgjimit telefonik dhe vëzhgimit ambiental.

➤ *Informacion mbi zbatimin e Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm*

Me qëllim zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë Berat janë hartuar, përveç masave konkrete të marra për zbatimin e tyre, si mbledhja e prokurorëve dhe diskutimi tyre, udhëzimet dhe urdhrat e mëposhtëm:

- **UDHËZIM nr.8 datë 31.10.2019 “Për funksionimin e procesit të plotësimit të regjistrimit për pasyqrimin e të dhënave për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal”**, i nxjerrë në bazë të neneve 41, 42 shkronja “a”, 44/1 të ligjit nr.97, datë 06.10.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Republikës së Shqipërisë”, neni 23 të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në

Republikën e Shqipërisë”, si dhe Qarkores së Prokurorit të Përgjithshëm “Për rritjen e efektivitetit në luftën ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” dërguar me shkresën nr.2843 prot., datë 25.10.2019

- **URDHËR nr. 4, datë 03.06.2019 “Për emërimin e personit të kontaktit për mbrojtjen e të dhënave personale”**, i nxjerrë në bazë të Ligjit Nr.113/2018 “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it”, si dhe të Ligjit Nr.9887/2008, i ndryshuar “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe Udhëzimit Nr. 47 datë 14.09.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për “Përcaktimin e Rregullave për ruajtjen e Sigurisë së të Dhënave Personale të Përpunuara nga Subjektet Përpunuese të Mëdha”.
 - **URDHËR nr.5 datë 21.06.2019 “Për emërimin e ZV/Drejtuesit të Prokurorisë”** i nxjerrë në mbështetje të të nenit 44 të Ligjit Nr.97/2016 datë 06 Tetor 2016 “Për organizmin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 101 datë 12 Qershor 2019 “Për miratimin e rregullave për emërimin e zëvendës drejtuesit të prokurorisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”
 - **URDHËR nr. 7/1 Datë 02.09.2019 “Për emërimin e koordinatorit të së drejtës së informimit”** në mbështetje dhe zbatim të nenit 61 të Ligjit Nr.97/2016 datë 06 Tetor 2016 “Për organizmin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 10 të Ligjit Nr. 119/2014 datë 18 Shtator 2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.05 datë 30.07.2019 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për marrëdhëniet me publikun në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”.
- Informacion mbi zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 20.06.2019 “Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë

Në kuadër të rezolutës së mësipërme, vlerësoj se një pjesë e konsiderueshme e kërkesave të parashtruara në rezolutën e Kuvendit janë përmbushur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat në përputhje me juridiksionin e saj dhe kompetencën lëndore e territoriale. Disa prej kërkesave të rezolutës janë faktikisht rubrika dhe gjetje më vete të këtij raporti siç është:

- kryerja e hetimeve proaktive nëpërmjet metodave speciale të hetimit me fokus veprat penale në fushën e korrupsionit,
- forcimi i bashkëpunimit ndërmjet Prokurorisë dhe policisë gjyqësore,
- rritja e bashkëpunimit me organet vendore e qendrore,
- rritja dhe konsolidimi i bashkëpunimit me autoritetet e huaja gjyqësore, bashkëpunim ky që realizohet me ndihmën e Prokurorisë së Përgjithshme dhe Ministrisë së Drejtësisë,

- ashpërsimi i politikës së dënimit në rastet e veprave penale të dhunës në familje, krimet ekonomik e financiar, personave përsëritës etj,
- ndjekja e një politike dënimi më të butë për kategoritë si gratë, personat me aftësi të kufizuar, të moshuarit etj;
- aplikimi i instituteve proceduralë si gjykimi me marrëveshje dhe urdhri penal etj.

Pavarësisht se konstatojmë që veprimtaria e Prokurorisë ka qenë në përputhje me kërkesat e mësipërme, vlerësojmë se ka vend ende për përmirësimin e treguesve të mësipërm, qëllim ky i cili arrihet jo vetëm me punën e Prokurorisë, por edhe me vullnetin e organeve të tjera shtetërore si Kuvendi, organet e pushtetit ekzekutiv, ministritë dhe institucionet të varësi të tyre, institucionet e tjera të pavarura si KLSH, ILDKPKI etj.

➤ *Informacion mbi zbatimin e rekomandimeve prioritare “Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2019”, miratuar me vendimin nr. 296, datë 10.05.2019 të Këshillit të Ministrave*

Në kuadër të rekomandimeve të Këshillit të Ministrave për vitin 2019 vlerësoj se jemi përpjekur për përmbushjen e prioriteteve të parashikuara në rekomandimet e Këshillit të Ministrave. Në këto të fundit, ndër prioritetet janë lufta ndaj korrupsionit dhe krimet të organizuar, respektimi i të drejtave të njeriut dhe bashkëpunimi ndërinstitucional.

- i) Në vitin 2019, në kuadër edhe të rekomandimeve të vitit 2018 dhe zbatimit të tyre me prioritet, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat janë regjistruar rreth 12 procedime penale për veprën penale të korrupsionit pasiv të zyrtarëve publikë, më vete ose njëkohësisht, edhe për vepra të tjera penale, kryesisht shpërdorim detyre.
- Janë zhvilluar hetime proaktive në drejtim të ndjekjes penale të veprës penale të “Korrupsionit pasiv të zyrtarëve publikë”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, kryesisht duke përdorur format e përgjimit telefonik dhe vëzhgimit ambiental, në pjesën më të madhe të procedimeve të mësipërme penale dhe kur është vlerësuar e arsyeshme që një teknikë e tillë hetimi mund të jepte rezultate provuese në hetim. Referimet lidhur me këtë vepër penale janë kryer kryesisht nga SHCBA-ja pranë Ministrisë së Brendshme, si edhe nga Seksioni kundër krimet financiar në DVP Berat, por përgjithësisht, kanë qenë materialet hetimore të paraqitura nga SHCBA-ja, ato të cilat janë ndjekur me hetime proaktive, për shkak se ka ekzistuar një dinamikë e caktuar për ngjarjet e referuara.
- Në disa prej rasteve nga ana e prokurorëve ka pasur edhe rezultate konkrete, ku në bazë të hetimit të kryer ka rezultuar e provuar kryerja e veprës penale të “Korrupsionit pasiv”. Në raste të tjera, është konkluduar mbi vepra të tjera penale, konkretisht, ajo e shpërdorimit të detyrës. Konkretisht, nga SHCBA-ja është referuar material hetimor për punonjës të policisë së Stacionit të Policisë Urë Vajgurore, Komisariati i Policisë Berat

për veprat penale të shpërdorimit të detyrës dhe korrupsionit pasiv (për përfshirje në ndërtimet e paligjshme masive në disa fshatra). Përgjatë hetimeve, janë paraqitur në gjykatë kërkesat për caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” për dy punonjës të policisë dhe drejtuesit të Stacionit të Policisë së Urës Vajguore (shpërdorim detyre+korrupsion pasiv), tre punonjës të IMT-së së bashkisë së Urës Vajguore dhe një kryepklak të një fshati, por, nga gjykatat janë vendosur masat e sigurimit personal të “Detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Në raste të tjera të procedimeve të tilla të ngjashme është arritur të provohet kryerja e veprës penale të shpërdorimit të detyrës nga punonjësit e policisë së shtetit, për të cilët edhe në këto raste janë paraqitur në gjykatë kërkesat për caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, por nga gjykata janë mbajtur qendrimet të ndryshme. Ky rast i fundit përfaqësohet nga procedimi penal i nisur në ngarkim të inspektorit dhe kryeinspektorit të IMT-së Bashkia Berat. Procedimet e mësipërme penale, bazuar në udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm i janë dërguar për kompetencë lëndore Prokurorisë së Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

- Lidhur me masat e sigurimit, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat është ndjekur një politikë e ashpër penale, në përputhje me rekomandimet prioritare, të cilat kërkojnë ashpërsimin e politikës lidhur me masat e sigurimit dhe dënimit të autorëve të këtyre veprave penale. Ky qendrim i organit të akuzës nuk ka gjetur mbështetje nga Gjykata e Shkallës së Parë Berat dhe Gjykata e Apelit Vlorë. Nëse i referohemi rastit të punonjësve dhe drejtuesit të policisë të Stacionit të Policisë së Urës Vajguore ka rezultuar se gjykatat kanë aplikuar kryesisht masën e sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.
- Lidhur me aksesin e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit në databaset shtetërore ende konstatohet se nuk është arritur që të realizohet nga pikëpamja teknike. Aktualisht, është në funksion dhe është përmirësuar sistemi lidhur me administrimin e certifikatës elektronike të gjendjes gjyqësore. Gjithashtu, një sistem tjetër ku është i mundur aksesin nga Prokuroria është ai i ALUIZNI-t mbi lejet e legalizimit dhe praktikant dokumentare. Duke marrë në konsideratë gamën e gjerë të informacioneve që duhet të shqyrtohen gjatë hetimit të veprave penale të tilla, është e nevojshme zgjerimi dhe mundësia e aksesit edhe në database të tjera si sistemi TIMS, të dhënat e ASHK, DPSHTRR, Drejtoritë e Doganave, Kufirit, Tatimeve etj, me qëllim rritjen e shpejtësisë dhe efikasitetit në hetim.
- Lidhur me rastet e hetimeve pasurore, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, ashtu si edhe prokuroritë e tjera të rrethve gjyqësore ka marrë kompetencën për trajtimin e këtyre rasteve pas suprimimit të Prokurorisë së Krimeve të Rënda. Aktualisht, prej kësaj të fundit janë dërguar për kompetencë 35 materiale, të cilat janë në fazën e hetimit pasuror.
- Përgjatë vitit 2019, ka vijuar të mbetet problematike mungesa e referimeve për veprën penale të korrupsionit nga ana e institucioneve të tjera ligjzbatuese, të cilat kanë detyrën

funkionale të mbledhjes së informacioneve në këtë drejtim, siç mund të jetë Policia e Shtetit, Shërbimi Informativ Shtetëror, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave apo dhe institucione të tjera si Drejtoria e Hetimit Tatimor rajoni jugor Fier-Berat etj.

- Në drejtim të forcimit të kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në periudhën raportuese kanë munguar trajnimet e përbashkëta me agjensitë ligjzbatuese të përfshira në luftën kundër korrupsionit.
- ii) Lidhur me zbatimin e rekomandimeve në luftën kundër krimit të organizuar, theksojmë se:
- Nga ana e prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat janë zhvilluar dhe janë në zhvillimin e sipër hetime të procedimeve penale për veprat penale të pastrimit të produkteve të veprave penale apo veprimtarisë kriminale, si edhe prodhimit dhe shitjes së narkotikëve. Në periudhën e mëparshme raportuese të 3-mujorit të kaluar ishin dërguar për gjykim 16 procedime penale për veprën penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve (sipas pg.1 dhe sipas pg.2), ndërsa aktualisht, janë dërguar në gjykim 19 procedime penale për veprën penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, duke përfshirë në këtë të dhënë edhe dosjet e mbartura prej viteve të kaluara dhe dosjet e reja të vitit 2019. Përgjithësisht, të gjithë të pandehurit e dërguar në gjykatë të akuzuar për veprën penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve kanë marrë vendime dënimi nga gjykata. Në vitin 2019 janë regjistruar 21 procedime penale për veprën penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, ku 7 procedime penale janë regjistruar për periudhën shtator-dhjetor 2019.
 - Lidhur me veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale, janë regjistruar përgjatë vitit 2019, 17 procedime penale. Për sa i përket të dhënave statistikore për këtë veprën penale, bëjmë me dije se nuk disponojmë për këtë vit tregues të dërgimit të dosjeve në gjykatë apo aplikimit të masave të sigurimit apo atyre pasurore. Rastet e regjistruara apo edhe ato të mbartura janë ende në hetim, ose të pezulluara apo pushuara në pritje të administrimit të përgjigjeve të letërporosive. Ashtu siç e kemi theksuar edhe në raportimet e mëparshme, vështirësia qendron në faktin se një pjesë e të dhënave hetimore është e nevojshme të përftohen nëpërmjet letërporosive në shtete të tjera, çka shkakton vonesa në hetimin e këtyre procedimeve penale, duke mos pasur në këtë mënyrë një impakt të shpejtë në ndjekjen e kësaj kategorie veprë penale.
 - Edhe sa u përket rekomandimeve në këtë fushë, vlerësohet e nevojshme rritja e numrit të trajnimeve për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore.
 - Lidhur me rekomandimet në luftën kundër krimit të organizuar dhe veprimtarive të tyre, sa i përket hetimeve, hetimeve pasurore, proaktive, bashkëpunimit ndër-institucional etj., nuk disponojmë të dhëna për shkak të mungesës së kompetencës mbi këtë lëndë.

- Lidhur me zbatimin e planit të Marrëveshjes me Eurojust-in dhe Planit të Veprimit të Prokurorisë së Përgjithshme dhe Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë Berat, në zbatim edhe të shkresës nr. 623/9, datë 27.05.2019 të Prokurorisë së Përgjithshme, është hartuar urdhri nr.4, datë 03.06.2019 “Për emërimin e personit të kontaktit për mbrojtjen e të dhënave personale”, duke u caktuar në këtë detyrë një oficer i policisë gjyqsore i seksionit të Prokurorisë, i cili ka për detyrë mbikqyrjen e brendshme të mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me aktet e mësipërme, urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 140, datë 03.09.2019 “Për miratimin e rregullores për mbrojtjen e të dhënave personale në shkëmbimin e informacionit me Eurojust” dhe Udhëzimet e Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.
 - Lidhur me zbatimin e ligjit nr. 108/2018 për vendosjen në regjimin e posaçëm të të dënuarve/paraburgosurve për veprat që parashikohen në këtë ligj, nuk disponojmë të dhëna, pasi kompetenca për aplikimin e këtij regjimi i takon Ministrin të Drejtësisë dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.
 - Edhe në këtë rubrikë, ashtu si në rubrikën e mësipërme, të rekomandimeve prioritare në fushën e luftës ndaj korrupsionit, konstatohet mungesa e aksesit në database shtetërore dhe mungesa e trajnimeve të përbashkëta me qëllim përmirësimin profesional në ushtrimin e ndjekjes penale për veprat penale të narkotikëve dhe pastrimit të parave.
- iii) Lidhur me zbatimin e rekomandimeve në fushën e respektimit të të drejtave të njeriut, nga ana e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqsore kryhen vazhdimisht përpjekje për zbatimin e tyre duke patur gjithnjë në fokus kategoritë vulnerabel që për arsye të ndryshme, bëhen pjesë apo palë të një procesi penal, veçanërisht të miturit, gratë, personat e dhunuar dhe ata me aftësi ndryshe.
- Në drejtim të zbatimit të rekomandimeve në këtë fushë, evidentojmë se janë dërguar në gjykim me procedurën e urdhrin penal deri në periudhën aktuale, 9 procedime penale, ndërsa 18 procedime penale janë dërguar në gjykim sipas procedurës së gjykimit me marrëveshje.
 - Është mbajtur në konsideratë që për veprat penale dhe autorët me rrezikshmëri të ulët shoqërore, të kërkohen përpara gjykatës zbatimi i dënimeve alternative, ku kryesisht është aplikuar pezullimi i ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim dhe vënia e të pandehurit në provë për një periudhë të caktuar, duke mbajtur kontakte me shërbimin e provës.
 - Përgjatë vitit 2019 nuk kemi raste të aplikimit të masës së shmangies për të miturit autorë të veprës penale, nga procedimi penal, por përgjatë kësaj periudhe të fillimit vitit 2020 jemi në prag të realizimit të aplikimit të masës së shmangies në disa raste me të mitur autorë të veprës penale.

- Është treguar kujdes lidhur me aplikimin e masave të sigurimit shtrënguese për të miturit autorë të veprave penale. Në përputhje me parimet e përcaktuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, caktimi i masave të sigurimit shtrënguese për të miturit është konsideruar si masë e fundit, vetëm nëse çdo masë tjetër e parashikuar në këtë Kod nuk është e përshtatshme.
 - Janë bërë përpjekje për zhvillimin e hetimeve të shpejta në rastet e çështjeve ku të miturit janë viktime ose autorë të veprave penale. Në këtë drejtim, duhet të mbahet në konsideratë jo vetëm kohëzgjatja e procedurës së hetimit nga ana e prokurorit dhe oficerit të policisë gjyqsore, por edhe kërkesat eventuale të palëve gjatë procesit të hetimit dhe sjellja e tyre.
 - Në përputhje me rekomandimet prioritare, janë ashpërsuar kërkesat për aplikimin e masave të sigurimit dhe dënimeve ndaj autorëve të veprave penale të ngacmimit seksual, përndjekjes, dhunës në familje etj.
 - Lidhur me veprat penale në fushën e zgjedhjeve, vlerësojmë të theksojmë se në qarkun e Beratit përgjatë fushatës zgjedhore, ditës së zgjedhjeve dhe periudhës post-zgjedhje nuk është konstatuar ndonjë problematikë e veçantë që do të përbënte rast për vepër penale në fushën e zgjedhjeve. Megjithatë, gjatë procesit të vërtetimit të mandateve të të zgjedhurve vendorë, në disa raste janë referuar kryesisht nga gjykata, të dhëna, prej të cilave dyshohet se mund të jetë konsumuar vepra penale e falsifikimit të materialit zgjedhor, raste për të cilat nuk janë gjetur elementë të veprave penale dhe i janë dërguar gjykatës me kërkesën për pushimin e procedimit penal.
 - Edhe në këtë rubrikë, ashtu si edhe ato të përshkruara më lart, vlerësohet se është tejet e nevojshme realizimi i trajnimeve me oficerë të policisë gjyqsore dhe prokurorë me qëllim përmirësimin e zbatimit të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.
- iv) Lidhur me bashkëpunimin ndërinstitucional, veçanërisht me Policinë e Shtetit, vlerësojmë se bashkëpunimi ka qenë korrekt dhe në përputhje me ligjin. Sipas të dhënave statistikore që disponon Prokuroria e Beratit rreth 986 procedime penale janë hetuar ose hetohen nga shërbimet e policisë gjyqsore të Drejtorisë së Policisë, ndërsa rreth 146 hetime të procedimeve penale kryhen nga oficerët e seksionit të Prokurorisë Berat.
- Lidhur me institucionet e tjera ligjzbatuese, por edhe me Policinë e Shtetit, përveç bashkëpunimit korrekt institucional ndërmjet tyre dhe Prokurorisë, konstatohet se mungojnë informacionet dhe referimet nga këto organe për veprat penale të korrupsionit, gjë që do të mundësonte dhe trajtimin e përshtatshëm, duke përdorur hetimet proaktive për hetimin e tyre.
 - Nga verifikimi i kryer rezulton se nuk ka pasur raste për materiale të dërguara nga Prokuroria e Përgjithshme në zbatim të ligjit nr. 138/2015 (dekriminalizimi). Për vitin 2019 rezulton se është referuar 1 material kallëzues nga KLSH-ja, i cili është në hetim, ndërsa nuk ka pasur materiale kallëzuese nga institucione të tjera qendrore.

➤ Informacion statistikor mbi çështjet penale që lidhen me procesin e verifikimit të Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emërohen ose Ushtrojnë Funksione Publike

Për vitin 2019, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat nuk ka patur procedime penale të regjistruara që lidhen me procesin e verifikimit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.

➤ Të dhëna lidhur me trajnimet e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore

Për shkak të ngarkesës tejet të lartë të prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat ka qenë e pamundur ndjekja e vazhdueshme e trajnimeve në kuadër të trajnimeve të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës. Trajnimet që janë ndjekur kanë qenë ato të organizuara nga Prokuroria e Përgjithshme dhe partnerët si Euralius, Opdat etj. Është për t'u përmendur që prokurorët Olgert Rumnici dhe Dritan Gripshi kanë zhvilluar trajnim me oficerët e policisë gjyqësore të DVP Berat lidhur me rolin e policisë gjyqësore në evidentimin dhe ndjekjen e veprave penale në fushën e zgjedhjeve, me rastin e fushatës zgjedhore dhe zgjedhjet lokale të datës 30.06.2019, në kuadër të programit trajnues të miratuar nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Sa u përket oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit të Prokurorisë Berat, nuk janë zhvilluar trajnime, për shkak të mungesës së një programi të mirëfilltë trajnimi për oficerë. Oficeri Romir Cufe ka qenë pjesëmarrës në trajnimin me temë mbrojtja e të dhënave personale në Prokurori, trajnim i organizuar në Prokurorinë e Përgjithshme në datën 22.07.2019.

➤ Problematikat e konstatuara

Përgjatë vitit 2019 kemi konstatuar problematikat e mëposhtme, të cilat kanë qenë të njëjtat edhe në periudhat paraardhëse dhe në një kuptim janë akumulim vit pas viti i këtyre problematikave.

- ❖ **Problematikat lidhur me ngarkesën e lartë të punës, në kuadër të mungesave në organikën e prokurorëve dhe oficerëve.** Nga analiza e statistikave, që do të bëhen prezente në vijim të raportit, rezulton se ngarkesa efektive për prokurorët e Prokurorisë Berat është mbi 800 dosje hetimore, në ndryshim nga viti paraardhës ku kishte mbi 500 dosje. Kjo ngarkesë u referohet prokurorëve Tasim Puci, Dritan Gripshi dhe Olgert Rumnici, të cilët kanë përballuar ngarkesën efektive të Prokurorisë Berat, ndërsa prokurorët Albjona Papajani dhe Gentian Habazaj janë emëruar/rikthyer rishtazi në Prokurorinë e Beratit. Nga kjo e dhënë është e nevojshme që përveç shtimit të organikës së Prokurorisë me prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore, të studiohen mundësitë nga pikëpamja e ligjit për statusin e magjistratit, së bashku me KLP-në, për caktimin përkohësisht të prokurorëve të tjerë, me qëllim përballimin e ngarkesës dhe përfundimin e dosjeve të mbartura. Një gjë e tillë do të kishte ndikim të

drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë së punës së prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, si edhe do të mundësonte ushtrimin e ndjekjeve penale efektive dhe zhvillimin e hetimeve të shpejta. Për vitin 2019 konstatohet një rritje e ngarkesës për prokurorët që shkon deri në **50% më shumë** krahasuar me vitin 2018, çka e bën të domosdoshme shtimin e numrit të prokurorëve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat. E njëjta situatë vërehet edhe për oficerët e policisë gjyqësore të seksionit të Prokurorisë. Përfundimi i procesit disiplinor për oficerin Gertmond Koroveshi dhe rikthimi i tij në punë, mund të zgjidhë përkohësisht problematikën e ngarkesës së oficerëve të seksionit, por në terma afatmesëm do të jetë e nevojshme plotësimi i trupës edhe me oficerë të tjerë.

- ❖ **Problematikat lidhur me pamundësinë për të kryer hetime në disa fusha të veçanta**, më konkretisht në fushën e abuzimit më sigurinë e produkteve ushqimore, për shkak të mungesës së legjislacionit përkatës, por edhe mungesës së vullnetit apo pamundësisë së disa institucioneve shtetërore për t'i dhënë përgjigje çështjeve të ngritura nga Prokuroria. Në raste të caktuara, të cilat kanë përbërë dhe interes për publikun, nuk është arritur të kryhen ekspertiza shkencore mbi produktet ushqimore nga autoritetet shtetërore siç mund të jenë AKU, ISHP, ISUV apo inspektoriati sanitar shtetëror etj. Si rrjedhojë e kësaj situatë, e cila vlerësojmë që do të na vërë përballë rasteve të shumta të kësaj fushe, veçanërisht me kuadrin ligjor penal aktual të ndryshuar, ku është rënduar politika penale, është e nevojshme bashkërendimi në nivel qendror me këto institucione, i nismës për të asistuar Prokurorinë në hetime të kësaj natyre.


II. Analiza e treguesve të kriminalitetit dhe punës së prokurorisë

➤ Volumi i punës në hetim

Pranë kësaj Prokurorie, gjatë vitit **2019** janë **regjistruar** gjithsej të reja **1006** (nga këto **12** ushtarake) dhe (**13** të ardhura me transferim) procedime penale. Në regjistrin përkatës të kësaj Prokurorie, gjatë vitit **2019**, janë regjistruar edhe **570** materiale për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal, ose janë në fazë verifikimi. Nga këto të dhëna të përgjithshme, rezulton se gjatë vitit **2019** (duke përfshirë procedimet dhe mosfillimet) në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat, janë **referuar gjithsej 1576** materiale hetimore të reja. Nga viti **2018**, janë **mbartur** gjithsej **925** procedime penale, me **312** persona të pandehur dhe **302** nën hetim, prej të cileve **84** të arrestuar. Në vitin **2019**, duke përfshirë tashmë edhe çështjet e mbartura, është ushtruar ndjekja penale në hetimin paraprak për **2582 materiale procedurale penale**, nga të cilat **1931** procedime penale.

✚ *Krahasuar me vitin 2018, këtë vit konstatohet një ngritje e lehtë e procedimeve penale me afërsisht 33 të tilla dhe e materialeve hetimore për mosfillim me 254 të tilla, pra, gjithsej në vitin 2019 janë referuar afërsisht 287 materiale hetimore më shumë se në vitin 2018. Përgjatë vitit 2019, krahasuar me vitin 2018, konstatohet rritje e numrit të referimeve penale, rrjedhimisht edhe shtimi i ngarkesës efektive të prokurorëve, fakt i cili nxjerr në pah problematikat me ngarkesën e lartë dhe organikën e prokurorëve.*

- Grafiku për vitet 2019 dhe 2018



	Procedime	Mosfillime	Materiale total	Te mbartura	Ngarkesa efektive
Viti 2019	1006	570	1576	925	2501
Viti 2018	973	316	1289	711	2000

➤ Çështje të përfaqësuara në gjykatë


Duke përfshirë edhe procedimet e mbartura në gjykim nga vitet e kaluara, gjatë periudhës njëvjeçare prokurorët janë paraqitur për të mbrojtur akuzën në gjykatë për **609** procedime penale, me **672 të pandehur**, nga të cilët **189** janë gjykuar nën masën e sigurimit «**arrest në burg**». Ka përfunduar gjykimi për **380** procedime penale, me **410** të pandehur, prej të cilëve **108** të arrestuar.

➤ Treguesit kryesorë të punës së prokurorisë

- Në vitin **2019**, janë **mosfilluar** gjithsej **280** materiale hetimore penale, si dhe janë mbartur në proces verifikimi për vitin në vazhdim (2020) dhe **290** materiale.
- Gjatë vitit 2019, janë **pushuar** gjithsej **235** procedime penale, nga të cilat:
92 procedime për **mungesë të faktit** penal,
18 procedime për **mungesë të provave** të mjaftueshme,
125 procedime për shkaqe **të tjera procedurale**, ndër më kryesoret e të cilëve heqjet dore nga të dëmtuarit për veprat penale që ndiqen mbi ankim, si dhe aplikimi i ligjit të amnistisë.
Në procedimet penale të pushuara :
Është **pushuar** ndjekja penale për **104** persona nën hetim, nga të cilët **0** kanë qënë të arrestuar.
- Gjatë vitit 2019, janë **pezulluar** gjithsej **158** procedime penale, të gjitha këto për shkak se nuk është bërë e mundur të zbulohet autori i veprës penale.
- Gjatë vitit **2019**, janë **transferuar** gjithsej **21** procedime penale, me **17** persona nën hetim. Ndër këta të fundit **4** persona i janë nënshtruar masës së sigurimit arrest në burg.
- Në vitin 2019, janë **dërguar për gjykim** gjithsej **407 procedime** penale, me **462** persona **të pandehur**. Ndër të pandehurit, **108** prej tyre kanë qënë me masë sigurimi arrest në burg, kurse pjesa tjetër janë ndjekur me masa të ndryshme sigurimi.

✚ *Krahasuar me vitin 2018, në vitin 2019 janë përfunduar nga prokurorët rreth 117 çështje penale më shumë. Konkretisht, për vitin 2018 janë marrë 984 vendimmarrje, ndërsa në vitin 2019 janë 1101 vendimmarrje. Kjo e dhënë reflekton intensitetin e lartë të punës së Prokurorëve dhe mangësitë në organikë.*

- **Grafiku për vitet 2019 dhe 2018**



	Vendimjarje		
Viti 2019	1101		
Viti 2018	984		

Të dhëna në lidhje me njoftimet për veprat penale

Në çështjet për të cilat është ushtruar ndjekja penale gjatë vitit **2019**, janë hetuar gjithsej **1230** persona, nga të cilët **651** persona **të pandehur** dhe **579** persona **nën hetim**. Ndër personat e hetuar **202** persona janë hetuar me masën e sigurimit **arrest ne burg**, kurse të tjerët janë ndjekur me masa të ndryshme sigurimi. Rezulton se në vitin 2019, **1** çështje penale ka filluar kryesisht, janë paraqitur **82** kallëzime nga shtetasit, **54** ankime nga shtetasit, **1165** referime nga policia e shtetit, nga këto **222** referime me vëndngjarje, **14** nga nënpunës publik, **14** nga tatimet, **9** nga policia pyjore dhe **12** referime nga policia ushtarake, **2** referime nga OSHEE, **1** nga K.L.SH, etj.

➤ *Të dhëna në lidhje me masat e sigurimit personal e pasuror*

Për vitin **2019**, treguesit e arrestimeve në flagrancë dhe ndalimeve, të kryer ndaj shtetasve të dyshuar për kryerjen e veprave të ndryshme penale, paraqiten si më poshtë:

- Janë **arrestuar në flagrancë** nga policia gjyqësore **217** shtetas.
- Janë **ndaluar me iniciativë** nga policia gjyqësore **15** shtetas.
- Është nxjerrë **urdhër** ndalimi nga **prokurori** për **3** shtetas.
- Është kërkuar nga prokurori caktim mase për **32** shtetas.
- Në **2** rast është disponuar me urdhër lirimi të menjëhershëm nga ana e prokurorit, pasi ka konstatuar arrestimin ose ndalimin si të paligjshëm.
- Eshtë kërkuar në gjykatë vlerësimi i arrestimit ne flagrancë apo ndalimit për **235** persona, ndër të cilët gjykata ka vlerësuar të ligjshëm **232** dhe të paligjshëm **3** të tillë.

Për vitin 2019, treguesit e kërkesave të prokurorit për masat kryesore të sigurimit, paraqitet si më poshte vijon :

- Nga **prokurori** është kërkuar në gjykatë për **133** persona caktimi i masës së sigurimit “**arrest në burg**”, ndërkohë që **gjykata** e ka caktuar këtë masë sigurimi ndaj **94** personave,
- Nga **prokurori** nuk është kërkuar ne asnjë rast caktimi i masës së sigurimit “**arrest në shtëpi**”, ndërkohë që **gjykata** e ka caktuar këtë masë sigurimi ndaj **9** personave,
- Nga **prokurori** është kërkuar për **0** persona caktimi i masës së sigurimit “**arrest në burg me afat**”, ndërkohë që **gjykata** e ka caktuar këtë masë sigurimi ndaj **19** personave,
- Nga **prokurori** është kërkuar për **100** persona caktimi i masës së sigurimit “**detyrim për paraqitjen në policinë gjyqësore**”, ndërkohë që **gjykata** e ka caktuar këtë masë sigurimi ndaj **110** personave.
- Nga **prokurori** për **2** persona nuk është kërkuar caktim i masës së sigurimit, ndërkohë që edhe **gjykata** nuk ka caktuar masë sigurimi ndaj **2** persona.
- Është kërkuar nga prokurori në **1** rast caktimi i masës së sigurimit pasuror-sekuestro preventive dhe **është pranuar kërkesa nga gjykata**.

➤ Treguesit e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë

Gjatë vitit 2019, janë nxjerrë gjithsej **933** urdhëra ekzekutimi. Nga këto **79** urdhëra janë me burgim, **345** me pezullim burgimi, **41** me gjobë, **468** urdhëra të ndryshëm kryesisht shpenzime procedurale, masa mjekësore dhe shuarje mase sigurimi.

➤ Kriminaliteti sipas shtrirjes territoriale

Në procedimet penale të gjykuara gjatë vitit 2019 janë gjykuar **384** shtetas, të cilët janë mbi 18 vjeç (dhe 7 shtetas të mitur). Banues në qytet janë **217** shtetas, ndërsa banues në fshat janë **167** shtetas. Nga të dhënat statistikore rezulton se shtrirjen më të madhe të kriminalitetit e kanë qytetet Berat dhe Kuçovë, me rrethinat e tyre, e më pas renditen Skrapari, Ura Vajgurore e Poliçani.

➤ Kriminaliteti sipas përhapjes së veprave penale dhe tendencave të tyre

Lidhur me gjendjen e kriminalitetit gjatë vitit 2019 është vënë re një ritje fare e lehtë e veprave penale të Kreut të Dytë të Kodit Penal, e konkretisht krime kundër personit **134** çështje me **39** persona nën hetim dhe **80** të pandehur. Nga këta **49** janë hetuar me masë sigurimi arrest në burg. Në lidhje me Kreun e Tretë të Kodit Penal, “Veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike”, janë regjistruar **539** proçedime penale me **141** persona në hetim dhe **92** të pandehur. Nga këta **29** të hetuar me masën e sigurimit **arrest në burg**. Është konstatuar një numër i përafërt me vitin e kaluar, i çështjeve që kanë të bëjnë me sferën ekonomike, kryesisht veprat penale të parashikuar nga neni 170/a (regjistruar **14** proçedime), 178 (**0** proçedime), 180 dhe 181 (regjistruar **43** proçedime), per nenin 186/1 (**20** proçedime), 187 (**3** proçedime), 189 (**3**

procedime), 190/1 (1 procedime), 191 (2procedim), 197 dhe 198 (6 procedime), 248 (40 procedime) dhe 259 (0 procedim).

➤ Kriminaliteti sipas strukturës së Kodit Penal (krime-kundërvajtje)

Bazuar në ndarjen e veprave penale sipas kategorizimit të tyre në krime dhe kundërvajtje penale, vlerësoj se krimet paraqesin tendencën më të lartë në vitin 2019 në qarkun e Beratit. Përgjatë vitit 2019 është hetuar për rreth 260 kundërvajtje penale dhe 746 krime.

III. Treguesit statistikorë 2 vjeçarë të veprave penale sipas strukturës së Kodit Penal

➤ **Në vitin 2017**

- Janë regjistruar 1099 procedime penale të reja (nga këto 1 procedime penale sipas KP Ushtarak)
- Në çështjet për të cilat është ushtruar ndjekja penale gjatë vitit 2017 janë hetuar 1210 persona, nga të cilët 702 të pandehur dhe 508 persona nën hetim.
- Janë dërguar në gjykim 418 procedime penale me 491 persona të pandehur
- Janë përfaqësuar në gjykim 593 procedime penale me 685 të pandehur.
- Ka përfunduar gjykimi i 395 procedimeve penale me 464 të pandehur, ku për 87 çështje penale është vendosur pushimi i çështjes për shkak amnistie, tërheqje ankimi, tërheqjes së akuzës ose pafajësi.

➤

➤ **Në vitin 2018**

- Janë regjistruar 973 procedime penale të reja (nga këto 5 procedime penale sipas KP Ushtarak)
- Në çështjet për të cilat është ushtruar ndjekja penale gjatë vitit 2018 janë hetuar 1167 persona, nga të cilët 694 të pandehur dhe 473 persona nën hetim.
- Janë dërguar në gjykim 409 procedime penale me 456 persona të pandehur
- Janë përfaqësuar në gjykim 609 procedime penale me 682 të pandehur.
- Ka përfunduar gjykimi i 348 procedimeve penale me 395 të pandehur, ku për 25 çështje penale është vendosur pushimi i çështjes për shkak amnistie, tërheqje ankimi, tërheqjes së akuzës ose pafajësi.

➤ Shënim: *Bashkëlidhur këtij raporti, gjenden tabelat e treguesve statistikorë të veprave penale sipas strukturës së Kodit Penal për vitet 2018, 2019.*

IV. Analiza e treguesve të efektivitetit të punës së prokurorisë

➤ Treguesi i efektivitetit në gjykimin dhe dënimin e të pandehurve

Duke përfshirë edhe procedimet e mbartura në gjykim nga vitet e kaluara, gjatë periudhës njëvjeçare prokurorët janë paraqitur për të mbrojtur akuzën në gjykatë për **609** proçedime penale, me **672 te pandehur**, nga te cilet **189** jane gjykuar nen masen e sigurimit « **arrest ne burg** ». Ka perfunduar gjykimi per **380** proçedime penale, me **410** te pandehur, prej te cileve **108** te arrestuar. Mbeten në gjykim **229** proçedime, me **262** të pandehur dhe **81** të arrestuar. Nga këto procedime është vendosur pushimi për **8** çështje, një pjesë e tyre për shkak te terheqjes së ankimit, amnistise dhe shkaqe te tjera.

- Në **5** raste është tërhequr akuza dhe kalimi i akteve prokurorise.
- Në **12** raste është vendosur pafajësi e plotë ose e pjesshme.

✚ *Në këtë seksion duhet përmendur numri relativisht i ulët i pafajësive/pushimeve krahasuar me vitin 2018, edhe pasi në vitin 2019 numri i çështjeve në gjykim ka qene i njëjtë me vitin 2018.*

➤ Të dhëna për gjykimet e posaçme

Ndër gjykimet për të cilat ka përfunduar gjykimi në shkallë të parë :

- Me proçeduren e **gjyimit te drejtpërdrejte** janë gjykuar **0** proçedime penale.
- Per **318 proçedime** penale eshte zhvilluar **gjykim i shkurtuar**,
- Per **4** procedime penale eshte zhvilluar gjykimi ne **mungesë**,
- **58** procedime janë zhvilluar me procedurën e gjyimit të zakonshëm.

✚ *Në këtë seksion duhet të mbahet në konsideratë se **18 çështje penale i janë dërguar gjykatës për miratim marrëveshje fajësie**, ndërsa **9 me kërkesë për miratimin e urdhrit penal**. Rrjedhimisht, treguesit e punës së prokurorëve në gjykim janë në nivele më të larta, pavarësisht se kolona e gjykimeve të drejtpërdrejta është **0**. Shpjegimi lidhur me këtë fakt është pikërisht aplikimi i alternativave të mësipërme të gjykimeve të posaçme : **marrëveshja e fajësisë dhe urdhëri penal***

➤ Të dhëna mbi llojet dhe masat e dënimeve

Ndër personat e deklaruar fajtorë në gjykimin në shkallën e parë :

- Nga prokurori është kërkuar dënimi me burgim për **138** raste, ndërsa gjykata ka dhënë në **114** raste dënim me burgim.

- Nga prokurori është kërkuar denimi me gjobe per **39** raste, ndersa nga gjykata eshte caktuar denimi me gjobe per **36** raste.
- Për **233** prej të dënuarve nga prokurori është kërkuar aplikimi i dënimit me kusht, ose punë në interes publik, ndërkohë që gjykata e ka aplikuar këtë dënim në **234** raste.

➤ *Të dhëna sociale dhe demografike për të pandehurit*

- Në procedimet penale të gjykuara gjatë vitit 2019 janë gjykuar **384** shtetas, të cilët janë mbi 18 vjeç (dhe 7 shtetas të mitur).
- Nga këta **356** janë meshkuj dhe **24** janë femra.
- Në lidhje me arsimin deri në nëntë klasë janë **245** shtetas. Me arsim të mesëm janë **119** shtetas dhe me arsim të lartë janë **20** shtetas.
- Nëpunës janë **9** shtetas. Të punësuar në sektorin privat janë **155** shtetas. Të papunë janë **220** shtetas.
- Banues në qytet janë **217** shtetas, ndërsa banues në fshat janë **167** shtetas.
- Përsëritës të të njëjtës veprë penale, janë **20** shtetas. Për vepra të tjera penale janë **30** shtetas.

➤ *Të dhëna për të pandehurit e mitur*

Nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat janë regjistruar **25** procedime penale me të mitur, si dhe kanë ardhur me transferim nga Prokuroria Vlorë, për përfaqsim në gjykim **16** procedime penale me të pandehur të mitur. Nga procedimet e regjistruara janë shënuar **17** të pandehur dhe **9** persona në hetim, nga këta **10** të grup moshës 14 – 16 vjeç dhe **16** të grup moshës 16 – 18 vjeç. Janë dërguar për gjykim **7** procedime me **7** të pandehur të mitur. Për sa i përket çështjeve më viktime të mitur, janë regjistruar **29** raste ku viktime kanë qënë persona të mitur, nga këta **8** femra dhe **21** meshkuj.

➤ *Të dhëna për pasojat e veprave penale*

Aktualisht, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat nuk ka një regjistër të posaçëm apo praktikë dokumentare lidhur me regjistrimin e pasojave të veprave penale. Duke përjashtuar veprat penale formale, për të cilat nuk është e nevojshme ardhja e pasojës, por kryerja e një veprimi apo mosveprimi në kundërshtim me ligjin penal, në rastet e veprave penale materiale, nisur edhe nga përhapja e gjerë në qarkun e Beratit, ato që shkaktojnë pasoja, janë kryesisht veprat penale të “Vjedhjes” të llojeve të ndryshme, të cilat i shkaktojnë këto pasoja në drejtim të pasurisë së individëve apo personave juridikë apo publikë. Do të evidentojta si me rëndësi edhe pasojat e shkaktuara nga veprat penale të kryera kundër shëndetit të personit apo nga shkeljet e rregullave të qarkulimit rrugor, të konfirmuara me aktet përkatëse mjeko-ligjore.

V. Të dhëna lidhur me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja

➤ Ekstradime, Letërporosi, Transferime procedimesh, Transferime te dënuarish, Shpalljet/Heqjet nga kërkimi ndërkombëtar

- Gjithsej, gjatë vitit 2019 janë dorëzuar në Gjykatën e Shkallës Pare Berat, **4** kërkesa për ekstradim për jashtë shtetit.
- Letërporosi për jashtë shtetit janë dërguar **12** kërkesa.
- Letërporosi nga jashtë shtetit gjithsej **17** kërkesa.
- Njohje e vendimeve penale të huaja gjithsej **6** vendime.
- Transferim procedimi **0** rast
- Shpallje në kërkim ndërkombëtar **2** shtetas
- Heqje nga kërkimi ndërkombëtar **13** shtetas

VI. Të dhëna për ngarkesën e punës për çdo prokuror dhe oficer të policisë gjyqësore

Gjatë vitit 2019, treguesit e përgjithshëm të volumit dhe cilesisë së punës së kryer nga prokurorët, duke përfshirë edhe çështjet e mbartura nga vitet e kaluara, paraqiten si më poshtë :

	T.Puci	O.Rumnici	D.Gripshi	A.Papajani	G.Habazaj	
Mos	117	48	86	25		
Pez	68	18	58	9		
Push	74	39	111	11		
Gjyk	166	62	150	26		
Trans	9	9	6	-		
Bash	4	1	11	7		
Hetim + Vlerë sim	198	644	444	70	44 materiale hetimore, nga këto 36 referime pasurore	
TOT	<u>636</u>	<u>821</u>	<u>866</u>	148	44	

✦ *Për qëllime krahasimi po paraqesim ngarkesën e punës së prokurorëve për vitin 2018. Nga krahasimi i tabelave kuptohet qartësisht rritja e ngarkesës së punës së prokurorëve Tasim Puci, Dritan Gripshi dhe Olgert Rumnici përgjatë vitit 2019, e cila është kushtëzuar nga mungesa e prokurorëve dhe intensiteti në rritje i materialeve hetimore të referuara në Prokurori.*

	T.Puci	O.Rumnici	D.Gripshi		
Mosfillime	107	48	62		
Pezullime	49	18	46		
Pushime	50	41	36		
Gjykime	175	98	115		
Transferime	10	7	11		
Bashkime	18	15	17		
Nën hetim	240	258	340		
TOTAL	<u>649</u>	<u>507</u>	<u>627</u>		

Gjatë vitit 2019, treguesit e përgjithshëm të volumit dhe cilësisë së punës së kryer nga Oficerët e policisë gjyqësore, duke përfshirë edhe çështjet e mbartura nga vitet e kaluara, paraqiten si më poshtë :

➤ **O.P.Gj. Romir Cufe**, gjithsej ka trajtuar **152** materiale hetimore, nga te cilat :

- Mosfilluar – 1 materiale.
- Pezulluar - 17 procedime penale.
- Pushuar - 39 procedime penale,
- Per gjykim - 47 procedime penale,
- Transferuar - 10 procedime penal.
- Bashkuar – 0 procedim penal.
- Ne hetim – 38 procedime penale.

✚ *Krahasuar me vitin 2018, ky oficer ka hetuar 6 materiale hetimore më shumë në vitin 2019.*

➤ **O.P.Gj. Erind Cela**, gjithsej ka trajtuar **139** materiale, nga te cilat :

- Pezulluar - 6 procedime penale.
- Pushuar - 20 procedime penale.
- Per gjykim - 53 procedime penale.
- Trasferuar - 1 procedime penale.
- Ne hetim – 59 procedime penale

✚ *Krahasuar me vitin 2018, ky oficer ka hetuar 55 materiale hetimore më pak në vitin 2019.*

- **O.P.G. Gertmond Koroveshi**, gjithsej ka trajtuar **52** materiale hetimore, nga te cilat :
 - Mosfilluar – 0 materiale.
 - Pezulluar - 0 procedime penale.
 - Pushuar - 1 procedime penale,
 - Per gjykim - 1 procedime penale,
 - Transferuar - 0 procedime penal.
 - Bashkuar – 0 procedim penal.
 - Ne hetim –50 procedime penale.

VII. Informacion mbi administrimin e Prokurorisë

Gjatë vitit 2019 personeli administrativ i kësaj prokurorie i ka kryer me korrektesë detyrat përkatëse, duke qene nje mbeshtetje e rëndësishme për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në përballimin e ngarkesës në punë dhe krijimin e raporteve korrekte me qytetarët, të cilëve u ofrohen shërbime administrative nga ana e Prokurorisë. Gjatë vitit 2019, buxheti financiar i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor është administruar me rigorozitet dhe si pasoje e disipline financiare dhe ndihmes gjithëvjetoje nga Prokuroria e Përgjithshme për zera të veçantë të tij, nga ana e kësaj Prokurorie janë likuiduar pothuajse të gjitha detyrimet ndaj subjekteve të tjerë, ato për shpenzimet procedurale, të pageses së mbikohës së punës etj. Megjithatë, vlerësoj se ky buxhet duhet të rishikohet në të ardhmen për shtimin e tij në zëra të veçantë për një mbarevajtje më të mirë të punës, duke u nisur nga fakti që nga viti në vit shtohet ngarkesa e punës dhe për rrjedhojë dhe nevojat financiare. Në cilësinë e Drejtuesit të Prokurorisë vlerësoj se marrëdhëniet me median dhe publikun kanë qenë korrekte. Nga ana e Prokurorisë është shprehur gatishmëria për të dhënë informacion subjekteve të interesuar në çdo rast që është gjykuar se nuk cenohen hetimi dhe veprimet procedurale përkatëse. Në respektim edhe të normave Kushtetuese është respektuar e drejta për informim e subjekteve të ndryshme. Në rast të refuzimit të kërkesave për informacione lidhur me çështje konkrete, ato janë argumentuar bazuar në normat procedurale penale mbi ruajtjen e sekretit hetimor. Lidhur me administrimin e dokumentacionit të Prokurorisë, konstatoj se jo vetëm regjistrat, por i gjithë dokumentacioni që administrohet në Prokurori mbahet dhe ruhet rregullisht. Lidhur me mbajtjen e regjistrave, në Prokurori ushtron veprimtarinë punonjësi i ngarkuar posaçërisht me detyrën e mbajtjes së tyre dhe deri më tani nuk konstatohen problematika. Përgjatë vitit 2019, vlerësoj se kapacitetet infrastrukturore kanë qenë të mjaftueshme me qëllim realizimin e aktivitetit të Prokurorisë. Megjithatë, kjo çështje meriton një vëmendje të veçantë në varësi edhe të organikës së Prokurorisë apo nevojave për të kryer detyra të caktuara. Sa i përket sigurisë, kjo realizohet nëpërmjet shërbimeve private të ruajtjes fizike, për të cilat çdo vit organizohet procedura përkatëse e prokurimit në përputhje me ligjin për prokurimin publik. Nuk rezulton të ketë pasur problematika lidhur me sigurinë, megjithatë, ashtu siç jam shprehur edhe në raporte të viteve paraardhëse, nisur nga natyra e veprimtarisë së Prokurorisë, vlerësoj se do të ishte e përshtatshme që siguria të garantohej nga shërbimet e

policisë të Drejtorisë së Policisë. Përgjatë vitit 2019 vlerësoj se përgjithësisht është respektuar disiplina në punë dhe etika nga prokurorët, oficerët dhe punonjësit e administratës, me përjashtim të rasteve të cilat janë referuar zyrtarisht në Prokurorinë e Përgjithshme dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë ndaj një prokurori të Prokurorisë së Rrethit Gjiqësor Berat.

VIII. Drejtimet dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2019. Rekomandime

Nga analiza në tërësi e elementëve që u përmendën më lart, paraqesim përfundimet dhe rekomandimet që mendojmë se i do i shërbejnë punës së mëtejshme të Prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat:

- Përfundimi më i rëndësishëm i analizës së mësipërme është konstatimi i faktit të rritjes së vazhdueshme të ngarkesës efektive të Prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat përgjatë vitit 2019. Në tërësi ngarkesa efektive në hetim ka qenë 2500 materiale hetimore, ngarkesë kryesisht e mbuluar nga tre prokurorët Tasim Puci, Dritan Gripshi dhe Olgert Rumnici, e cila e bën imediate dhe në mënyrë urgjente nevojën për shtimin e organikës me prokurorë dhe oficerë të tjerë. Duke marrë në konsideratë kontekstin aktual ligjor, si edhe ngarkesën e punës së prokurorëve dhe oficerëve, ashtu siç kam propozuar edhe në vitet paraardhëse, do të vlerësoja se një numër më i lartë prokurorësh dhe oficerësh të policisë gjyqësore, do të bënte të mundur vijueshmërinë normale të punës në Prokurori. Po t'i referohemi statistikave, tre prokurorët e mësipërm përballojnë mbi 800 materiale hetimore. Gjithashtu, konstatohet edhe problematika e mangësive në organikën e oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit të Prokurorisë.

Nga ana tjetër kjo do të ndihmonte në realizimin e objektivave të mëposhtme

- Përfundimi në një afat sa më të shkurtër i procedimeve penale të mbartura nga viti 2019 dhe vitet e kaluara.
- Vazhdimi i ndjekjes me përparësi të procedimeve penale në fushën e krimit ekonomik dhe abuzimit me detyrën nga nëpunësit shtetërorë, në fushën e veprave penale kundër jetës së personit dhe moralit, pasurisë, rendit dhe sigurisë etj.
- Intensifikimi i përpjekjeve nga prokurorët për të bërë të mundur rritjen e treguesve të zbulueshmerisë së veprave penale me rrezikshmeri të lartë shoqërore dhe marrjen në përgjegjësi penale të subjekteve përkatëse, si pastrimin e produkteve të veprës penale, vjedhjet etj, të cilat janë më të ndjeshme për shoqërinë tonë.
- Rritja e funksionit drejtues dhe kontrollues të prokurorit ndaj policisë gjyqësore, në seksionin dhe shërbimet e policisë gjyqësore.
- Përmirësimi i organizimit, drejtimit dhe kontrollit të punës brenda organit, me qëllim për t'iu përgjigjur më mirë kërkesave për rritjen e cilësisë së punës.

- Respektimi nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore i detyrimeve të ligjit procedural penal, urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm dhe atyre të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
- Rritja e profesionalizimit të prokurorëve në hetimin paraprak, në marrjen e vendimeve përfundimtare, në paraqitjen e kërkesave para gjyqtarit të seancës paraprake dhe në mbrojtjen e akuzës në gjykim si dhe ruajtjen e etikës dhe disiplinës në punë.

HARTOI:

DREJTUESI I PROKURORISË

ELOIDA GOXHI

